

E ENJTE DATA 23 SHKURT 2023

FJALA E DEPUTETES ETILDA GJONAJ

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Integrimi europian është një proces me shumë rëndësi për vendin, me shumë rëndësi për qytetarët, për të realizuar ëndrrën e shqiptarëve për të qenë qytetarë të Bashkimit Europian. Për fat të keq, në vend që të flasim për këtë çështje në interes të njerëzve, tashmë e kemi kthyer ditën e seancës plenare në një ditë të betejës politike. Tashmë është bërë zakon që në pjesën më të madhe të diskutimeve në këtë parlament, shumë pak flitet për përgjegjësinë tonë si ligjvënës, por përfshihemi në debate politike, në zhurma ku nuk lejojmë as njëri-tjetrin të dëgjojmë, dhe aq më tepër qytetarët, deri në akuza penale, duke marrë rolin e gjyqtarit dhe të prokurorit, duke harruar, në fakt, misionin për të cilin jemi në këtë sallë: për të përfaqësuar dhe për të adresuar problematikat e njerëzve, që na kanë sjellë këtu si përfaqësuesit e tyre. Në vend që të flasim për projektligjet që kalojnë nëpër procese kaq të rëndësishme, siç është integrimi europian, se çfarë ka bërë qeveria apo strukturat e tjera dhe çfarë përfitojnë njerëzit nga ky proces, ngërthehemi të gjithë në retorikën politike të ditës. Do të ishte në nderin tonë që diskutimet për çështjet e integritit europian t'i kryenim me debate parlamentare, me etikë, por, nga ana tjetër, edhe konstruktive, me qëllim që të arrijmë të nxjerrim problematikat, duke sjellë argumente kundër ose pro, secili prej nesh, sipas bindjes së vet apo sipas agjendës politike, por ama të arrijmë në disa rezultate, të cilat e ndihmojnë procesin. Në fund të fundit, roli i parlamentit në këtë proces është për t'i dhënë një mundësi dhe për të qenë një vlerë e shtuar për përshtetimin e tij, pavarësisht përgjegjësisë direkte që kanë qeveria dhe të gjitha strukturat negociuese për të avancuar procesin e integritit europian.

Gjatë vitit 2022, Këshilli Kombëtar i Integritit Europian, bazuar në misionin e tij gjithëpërfshirës, por njëkohësisht edhe në përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit në BE, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë rolit që luan në drejtim të garantimit të bashkëpunimit jo vetëm nëpërmjet forcave politike dhe institucioneve publike, por veçanërisht nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile, grupet e interesit apo edhe me vetë qytetarët, duke shërbyer kështu si një mekanizëm për të diskutuar arritjet sipas rekomandimeve të progresraportit për Shqipërinë, ashtu si edhe plotësimin e detyrimeve të raportimit nga qeveria, në këtë sallë të rëndësishme, të negociatave, për të dhënë informacionin e duhur se çfarë është realizuar deri tani nga qeveria, sidomos për prioritetet kryesore të zbatimit të reformës në drejtësi apo të luftës kundër korrupsionit, që bëjnë pjesë në grupkapitujt e parë të konsideruar "cluster 1", që konsiderohen si themeloret. Këshilli Kombëtar i Integritit Europian i ka kushtuar veçanërisht vëmendje nxitjes së dialogut konstruktiv, si një platformë këshillimore dhe gjithëpërfshirëse, njëkohësisht edhe përmirësimit të njohurive për procesin e integritit europian për të gjitha grupet e interesit, por, nga ana tjetër, edhe transparencës, si një domosdoshmëri në këtë proces kaq të rëndësishëm dhe sfidues njëkohësisht. Duhet të vlerësojmë të gjithë punën profesionale që është bërë deri tani nga struktura negociatore dhe nga ministrja e Shtetit për Integritin Europian, duke përfshirë këtu edhe stafet pjesëmarrëse të të gjitha institucioneve shtetërore, të cilat kanë raportuar pranë Komisionit Europian për vlerësimin e legjislacionit shqiptar, për sa u përket "cluster

l' apo grupkapitujve të parë, që lidhen me çështjet themelore. Mund të them se këtu ka pasur një sukses të jashtëzakonshëm, vlerësuar jo thjesht nga ne, por nga autoritetet e Komisionit European, që kanë bërë vlerësimin e këtij procesi, duke e konsideruar si një proces jo vetëm të marrë shumë seriozisht nga stafet tona, por, nga ana tjetër, edhe në aspektin profesional, i cili është shumë herë më mirë sesa vendet e tjera. Nga ana tjetër, ashtu siç e përmendi edhe zoti Balla, ne jemi përfshirë në një proces shumë të rëndësishëm, duke ngritur një komision ad hoc të përkohshëm, për rishikimin e ligjit për rolin e parlamentit në procesin e integritit european. Mund të them se ka qenë një proces ku komisioni ad hoc ka përfshirë të gjithë aktorët politikë që ndodhen në parlament, duke mbajtur në konsideratë tre parime kryesore për paraqitjen e kësaj pakete ligjore, që përfshin jo vetëm ndryshimet e ligjit, por dhe ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit, si dhe ndryshimet për sa u përket vendimeve administrative që do të marrë Byroja e Kuvendit dhe që do të propozohen në ditët në vijim: duke marrë në konsideratë gjithëpërfshirjen e të gjitha partive politike apo edhe aktorët e shoqërisë civile; e dyta, duke mbajtur në konsideratë parimin për rritjen e transparencës së procesit, për të informuar qytetarët për procesin e integritit european dhe njëkohësisht se çfarë përfitojnë ata nga ky proces, por, nga ana tjetër, edhe rritjen e llogaridhënies së qeverisë ndaj qytetarëve, si dhe strukturave negociuese në aspektin e negociatave, por, njëkohësisht, edhe çështje të caktuara, sipas grupkapitujve. Edhe Këshilli Kombëtar i Integritit European, ashtu si edhe Komisioni i Integritit European, nëpërmjet kësaj pakete vjen me një rol të shtuar, duke e konsideruar, gjithashtu, Këshillin Kombëtar të Integritit European si një platformë më të hapur, duke mos i kufizuar aktorët e shoqërisë civile që mund të marrin pjesë në të, por edhe duke lënë të pakufizuar pjesëmarrjen e tyre, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes aktive jo vetëm thjesht të shoqërisë civile, por edhe të qytetarëve shqiptarë.

E dyta, është me shumë rëndësi të përmendet se është rritur roli i Këshillit Kombëtar të Integritit European, në kuadër të monitorimit që vetë ky Këshill do t'i bëjë zbatimit të detyrimeve të proceseve negociuese nga ana e qeverisë, duke pasur kështu mundësinë edhe në diskutime, por edhe për të dhënë rekomandime konkrete për çka mund të përmirësohet në këtë proces shumë të gjatë dhe shumë sfidues për hapjen e negociatave. Roli i Kuvendit në procesin e integritit european është i rëndësishëm edhe në dimensionimin politik, por, nga ana tjetër, edhe në rolin e përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*, ashtu si edhe me zbatimin e detyrimeve për procesin e integritit në Bashkimin European, njëkohësisht edhe në rolin bashkëpunues që do të ketë me Parlamentin European dhe përfshirjen në të gjitha aktivitetet nëpërmjet diplomacisë parlamentare me parlamentet e vendeve të tjera europiane. Shumë shpejt kjo paketë ndryshimesh do të vijë për miratim në parlament, duke shpresuar të kemi mundësinë të zhvillojmë debat konstruktiv, të paktën, për çështjet e integritit european. Unë besoj se, nëse ne do të kemi kërkesë apo nevojë për të diskutuar për çështjet e integritit european, të nderuar kolegë, ne këtë mund ta kryejmë në çdo seancë. E rëndësishme është të kemi mundësinë të respektojmë parimet e parlamentarizmit, të respektojmë etikën e deputetit, me qëllim që edhe çështje të tilla, të cilat janë mbi agjendën tonë politike, por që janë agjenda e shqiptarëve, të diskutohen më gjerësisht në këtë parlament. Faleminderit!